

KONTRATË

Numri i kontratës:¹ 622-24-5611-5-2-1/C1453

KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë; dhe

Grup i Operatorëve Ekonomik ENG GEO GROUP SH.P.K.; Milazim S. Shala, Bellanice-Malisheve, Malisheve, (në vazhdim "Kontraktuesi"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për punë e shënuara me poshtë:

Ndërtimi dhe vendosja e shtëpizave mobile ne kuadër të projektit Ringjallja e Zejeve dhe Ndërtimi i Kultures për Zhvillimin e përbashkët të turizmit ne Bazë të marrëveshjes për bashkëpunim me nr 2022 434-320 ne mes të BE dhe KK Prizren me numër identifikues: 622-24-5611-5-2-1

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës është ekzekutimi i punëve në vijim nga ana e Kontraktuesit: **Ndërtimi dhe vendosja e shtëpizave mobile ne kuadër të projektit Ringjallja e Zejeve dhe Ndërtimi i Kultures për Zhvillimin e përbashkët të turizmit ne Bazë të marrëveshjes për bashkëpunim me nr 2022 434-320 ne mes të BE dhe KK Prizren**

No.	Lot
1	Ndërtimi dhe vendosja e shtëpizave mobile ne kuadër të projektit Ringjallja e Zejeve dhe Ndërtimi i Kultures për Zhvillimin e përbashkët të turizmit ne Bazë të marrëveshjes për bashkëpunim me nr 2022 434-320 ne mes të BE dhe KK Prizren

Neni 2 Çmimi

2.1 Çmimi total i punëve duhet të jetë: **21,170.00 €** (njëzet e një mijë e njëqind e shtatëdhjetë euro).

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

2.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

Marrëveshja e kontratës;

Kushtet e Veçanta të Kontratës;

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;

Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;

Oferta financiare (Paramasa dhe Paralogaria);

(Procesverbali i mbledhjes informative/vizitës së vendit)

[shëno çdo dispozitë tjetër të dosjes së tenderit].

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

¹ Ju lutemi referojuni këtij numri të kontratës në dokumentet e faturimit dhe pagesës, procedurat dhe transaksionet që lidhen me thesarin.

Neni 4

Komunikimet


4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.

4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën ² në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	Isa Osmankaj
Pozita:	Zyrtar përgjegjës i prokurimit
Nënshkrimi:	
Data:	01.08.2024
Vula:	

Për Kontraktuesin

Emri:	Mensur Sertolli
Pozita:	Menaxher
Nënshkrimi:	
Data:	01.08.2024
Vula:	

² Gjuha do të jetë gjuha e shfrytëzuar nga tenderuesit në këtë tender.

KUSHTET E VEÇANTA

Numri i kontratës: 622-24-5611-5-2-1/C1453

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë gjuha Shqipe .
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shuma e sigurisë së ekzekutimit është 10% i vlerës së kontratës me vlefshmëri prej 2 muaj kalendarik .
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	Shuma minimale e sigurimit do të jetë: (a) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim lidhur me punët, ndonjë pjesë të tyre, materialet apo implantin gjatë periudhës mbi të cilën kontraktuesi është përgjegjës për përkujdesjen e tyre, për çfarëdo arsye, përpos rreziqeve të definuara sipas nenit 38 të KPK, kontraktuesi korrigjon humbjen apo dëmtimin e tillë nën shpenzimet e veta, në mënyrë që punët e përhershme në çdo aspekt të jenë në përputhje me dispozitat e kontratës sipas kërkesave të menaxherit të kontratës. Kontraktuesi siguron punët, së bashku me materialin dhe implantin gjatë në koston e zëvendësimit të plotë; (b) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i Pajisjeve një shumë e cila është e njaftueshme për zëvendësimin e tyre; (c) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën shuma minimale është 15.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar. (d) Nëse ndodh ndonjë dëmtim personal ose vdekje: (i) e punëtorëve të Kontraktuesit: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar (ii) e personave të tjerë: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar
Programi	12.1	Kontraktuesi do ta dorëzoj për aprovim Programin për Punët brenda 3 ditëve nga data e Nënshkrimit të kontratës.
	12.2	Periudha për Programin e azhurnuar është 03 ditë nga data e pranimit të kërkesës së Menaxherit të projektit .

Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të jetë .dy dit pas hyrjes në fuqi të kontratës
	17.2	Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë 30 ditë pune nga data e hyrjes në fuqi të kontratës
Dëmet e likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë 0.25% e Çmimit përfundimtar të Kontratës për ditë. Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është 10% e Çmimit final të Kontratës .
Regjistri i punës	20.1	Një regjistër i punës do të mbahen në vend-punishite nga ana e Kontraktuesit,
Inspektimi dhe testimi	22.1	Mbikqyrës i drejtpërdrejt i menaxherit të kontratës do të jetë: Ramadan Tarashaj Drejtor në DTZHE Menaxheri i Kontratës është: Laura Suka IDA në DSHP
Parapagimi		Shuma e Parapagimit është: nuk ka pagese paraprake
Mbajtja e Parasë	27.1	Shuma e parave të mbajtura është: e vlerës se kontratës.
Shkaqet për kompensim	30.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë 3 ditë pas nënshkrimit të kontratës.
Përgjegjësia mbi Defektet	34.5	Periudha garantuese e defekteve është 2 vite kalendarike pas pranimit përfundimtar të punimeve.
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	39.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është përqindja e vlerësuar të punëve të pakryera minus shuma e dëmeve të likuiduara.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	Neni 42 42.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë: a) ose vendim nga gjyqi; b) kurdo që palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK. 43.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

AUTORITETI KONTRAKTUES

KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT, Remzi Ademaj, -20000, PRIZREN,

Zyrtari përgjegjes i prokurimit:

Nr i Prokurimit: 622-24-5611-5-2-1

OPERATOR EKONOMIK:

Emri i kompanisë dhe adresa e plote: **Grup i Operatorëve Ekonomik ENG GEO GROUP SH.P.K.; Milazim S. Shala, Bellanice-Malisheve, 24000, Malisheve, Kosovë**

E-mail: **ENGGEOSHPK@GMAIL.COM**

Personi kontaktues: **Mensur Sertolli**

Telefoni: **049718472**

Faxi:

Numri fiskal:

Grup i operatorëve ekonomik (nëse aplikohet):

Partneri 1.

Emri i kompanisë: **Milazim S. Shala**

Numri fiskal: **810629529**

Vend-Selia: **rruga shtjfish gjeqovi nr 77, 20000, Prizren, Kosovë**

Partneri 2.

Emri i kompanisë: **ENG GEO GROUP SH.P.K.**

Numri fiskal: **811590331**

Vend-Selia: **Bellanice-Malisheve, 24000, Malisheve, Kosovë**

FORMULAR PËR DORËZIMIN E TENDERIT

Pjesa I. Formulari i Tenderit

Numër të Prokurimit: 622-24-5611-5-2-1

Titulli i kontratës: Ndërtimi dhe vendosja e shtëpizave mobile ne kuadër të projektit Ringjallja e Zejeve dhe Ndërtimi i Kultures për Zhvillimin e përbashkët të turizmit ne Bazë të marrëveshjes për bashkëpunim me nr 2022 434-320 ne mes të BE dhe KK Prizren

Si përgjigje ndaj letrës suaj të ftesës për të tenderuar për kontratën e mësipërme, ne, të poshtë nënshkruarit, deklarojmë që:

1. i kemi kontrolluar dhe pranuar plotësisht përmbajtjet e dosjes së tenderit. Ne pranojmë dispozitat e saj në tërësi, pa rezervim ose kufizim.
2. Ne ofrojmë të dorëzojmë, në pajtim me kushtet e dosjes së tenderit dhe afatet kohore të paraqitura, pa rezervë apo kufizim:

- 1 Ndërtimi dhe vendosja e shtëpizave mobile ne kuadër të projektit Ringjallja e Zejeve dhe Ndërtimi i Kultures për Zhvillimin e përbashkët të turizmit ne Bazë të marrëveshjes për bashkëpunim me nr 2022 434-320 ne mes të BE dhe KK Prizren

3. Çmimi total i tenderit është:

20,930.00 EUR

Dhe në fjalë [shëno çmimin e tenderit në fjalë Euro]


4. Ky tender është valid për një periudhë prej ose muaj: ose dite: 90 nga data finale për dorëzim të tenderëve.

5. Nëse tenderi jonë pranohet, ne marrim përsipër të sigurojmë një siguri të ekzekutimit para nënshkrimit të kontratës

6. Ne e bëjmë këtë kërkesë, për këtë tender [shëno numrin e Pjesës, nëse aplikohet] si partner në konsorcium të udhëhequr nga [shëno emrin e udhëheqësit]. Ne konfirmojmë që nuk jemi duke tenderuar për të njëjtën kontratë me ndonjë formular tjetër. Konfirmojmë, si partner në konsorcium, se të gjithë partnerët, bashkërisht dhe veç e veç, janë të detyruar me ligj për realizim të kontratës; se partneri kryesor është i autorizuar të obligojë dhe të marrë udhëzime për secilin anëtar dhe në emër të secilit anëtar që realizimi i kontratës, duke përfshirë edhe pagesat, është përgjegjësia e partnerit kryesor, dhe se të gjithë partnerët në ndërmarrjen e përbashkët/konsorcium janë të obliguar të mbeten në ndërmarrjen e përbashkët/konsorcium gjatë tërë periudhës së realizimit të kontratës.

7. Ne do ta informojmë Autoritetin kontraktues menjëherë nëse ka ndonjë ndryshim në rrethanat e mësipërme në cilëndo fazë gjatë implementimit të kontratës. Gjithashtu ne e dimë dhe pranojmë që të gjitha informatat e pasakta ose jo të plota të cilat jepen me qëllim në këtë konkurrim, mund të kenë si

IPA- K.K. Prizren					
PARALLOGARIAE KIOSKAVE-SHTANDEVE					
Kushtet e Përgjithshme					
Përshkrimi i punimeve. Në përputhje të plotë me standardet Evropiane dhe ISO					
Masat e sigurisë duhet të jenë të nivelit të lartë dhe konform me legjislaturën në fuqi për sigurimin e punishtës dhe të puntorëve gjatë punimeve. Për çdo ndryshim gjatë realizimit të punimeve duhet të konsultohet organi mbikqyrës					
Të gjitha pozicionet përfshijnë furnizimin me material, transportin, shkarkimin, si dhe funksionalizimin në vendet të përcaktuara për 6 copë kioska (shtande).					
Nr.	Përshkrimi	Njësia	Sasia	Çmimi PA TVSH (€)	Shuma PA TVSH (€)
1	Punët Përgaditore				
1.1	Ingjizimi gjeodezik i lokacionit për 6 kioska	m2	1,000.00	1	1,000.00 €
1.2	Pastrimi i terrenit dhe organizimi i punishtës për rregullimin e kioskave-shtandeve.	m3	1000	3	3,000.00 €
				Shuma	4,000.00 €
2	Punët e gërmimit dheut dhe mbushjet				
2.1	Hapja e themeleve për ankerimin e ankerave të shtandeve në thellësi minimale h=50cm.	copë	24	20	480.00 €
2.2	Rregullimi i dyshemes për rreth ankerave të kioskave-shtandeve.	copë	24	20	480.00 €
				Shuma	960.00 €
3	Punët e betoneve				
3.1	Furnizimi, transporti dhe betonimi i ankerave me dimensione minimale 50x50x50cm me vendosje e ankerave në aendër.	copë	24	20	480.00 €
				Shuma	480.00 €
4	Punët e konstruksionit metalik të kioska-shtandeve				
4.1	Furnizimi, transporti, saldimi dhe punimi i shtyllave dhe trajeve kryesore me profila metalik me dimensione 100x80x3 mm. Lyerja e profilave metalik të bëhet me dy lyerje ngjyrë antikorodive dhe dy lyerje ngjyrë të zezë.	kg	1680	1.7	2,856.00 €
4.2	Furnizimi, transporti, saldimi dhe punimi mbushjeve horizontale dhe vertikale nga profila metalik me dimensione 60x40x2.5 mm. Lyerja e profilave metalik të bëhet me dy lyerje ngjyrë antikorodive dhe dy lyerje ngjyrë të zezë	kg	990	1.7	1,683.00 €
4.3	Furnizimi, transporti, saldimi dhe punimi rafteve të mbrendshme, derës dhe dritareve sipas projektit, nga profila metalik me dimensione 40x30x2.5 mm. Lyerja e profilave metalik të bëhet me dy lyerje ngjyrë antikorodive dhe dy lyerje ngjyrë të zezë	kg	945	1.8	1,701.00 €




4.4	Furnizimi, transporti dhe mveshja me material dekorativ me pllaka USB nga druri me trashësi minimale t=11mm, në pjesen e mbrendshme duke përfshirë pllafonin dhe muret e kioskave-shtandeve.	m2	150	20	3,000.00 €	✓
4.5	Furnizimi, transporti dhe mveshja me material dekorativ me dërrasa nga druri bingu i përpunuar në pjesen e jashtme të kioskave-shtandeve. Lyrja të bëhet me një shtresë sadolini dhe me dy shtresa ngjyrë vaji të përzgjedhur nga OM.	m2	150	25	3,750.00 €	✓
4.6	Furnizimi, transporti dhe punimi i termoizollimit të mureve të kioskave-shtandeve me lesh guri në trashësi t=10 cm dhe dendësi minimale 50kg/m³.	m2	150	10	1,500.00 €	✓
4.7	Furnizimi, transporti dhe punimi i mbulesës së kioskave me sandwich trashësi min. t=5cm, ngjyra dhe forma të përcaktohet nga OM.	m2	20	25	500.00 €	✓
4.8	Furnizimi, transporti dhe punimi i ullukeve horizontal dhe vertikal duke përfshirë edhe izolimet kendore me llamarin në mbulesën e kioskave.	m2	20	25	500.00 €	✓
Shuma					15,490.00 €	✓

5 Punët e elektrikës

5.1	Furnizim, transporti dhe montimi i kablilit furnizues nga kyqja më e afërt deri në mbrendi të kioskës, distanca nga 15 deri në 30 m duke përfshirë edhe materialet tjera përcjellëse.	copë	6	20	120.00 €	✓
5.2	Furnizimi, transporti, shpërndarja dhe montimi i kablilve mbrenda kioskes, minimum dy drita një mbrenda dhe një ng jashtë në pjesen e përparme si dhe minimum dy priza me të gjitha elementet përcjellëse deri në finalizim.	copë	6	20	120.00 €	✓
Shuma					240.00 €	✓

Nr	REKAPITULIMI I PUNËVE TË KIOSKAVE-SHTANDEVE NË SHESHIN TEK URA E ARASTËS KK PRIZREN	
1	Punët Pregaditore	4,000.00 €
2	Punët e gërmimit dheut dhe mbushjet	960.00 €
3	Punët e betoneve	480.00 €
4	Punët e konstruksionit metalik të kioska-shtandeve	15,490.00 €
5	Punët e elektrikës	240.00 €
Gjithsej punët e Kioskave-Shtandeve		20,930.00 €





ELSIG

Kompania e Sigurimeve Sh.A./Insurance Company J.S.C.

Gjithcka që duhet ta keni

Deklaratë e Garantuesit

SIGURIA E EKZEKUTIMIT

Pjesë përbërëse e Policies me Nr. **128919**

Për **KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT**

(Emri i "Autoritetit Kontraktues")

Në emër të **ENG GEO GROUP SH.P.K.**

(emri dhe adresa e "Operatori Ekonomik" dhe nr. i biznesit në vazhdim Operatori Ekonomik)

Titulli i aktivitetit të prokurimit: **Ndërtimi dhe vendosja e shtëpizave mobile ne kuadër të projektit Ringjallja e Zejeve dhe Ndërtimi i Kultures për Zhvillimin e përbashkët të turizmit ne Bazë të marrëveshjes për bashkëpunim me nr 2022 434-320 ne mes të BE dhe KK Prizren**

Nr. prokurimit: 622-24-5611-5-2-1 , Nr. brendshëm: 622-24-097-5-2-1

Garancion me kërkesë të parë

Derisa operatori ekonomik i lartëcekur, ka ndërmarrë veprimet për të dorëzuar një siguri të ekzekutimit duke iu referuar dosjes së tenderit me numër të prokurimit të lartëcekur të dërguar nga autoriteti kontraktues, dhe ngase tenderuesi dëshiron të depozitoi garancinë në shumën e saktësuar në dosjen e tenderit, dhe ngase jemi pajtuar t'i japim tenderuesit këtë garanci.

Andaj me këtë konfirmojmë se jemi garantues dhe përgjegjës para jush, në emër të operatorit ekonomik, deri në një shumë totale: **2,117.00€** zotohemi të ju paguajmë, që me kërkesën tuaj të parë me shkrim në të cilën deklarohet mospërputhja e njërit nga kushtet në vijim:

- Autoriteti kontraktues konstaton në bazë të dëshmimeve të vertetuara objektivisht se operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe kjo i ka shkaktuar autoritetit kontraktues dëme substanciale dhe/ose shpenzime të mëdha për mbylljen e kontratës në fjalë, dhe;
- Operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe si rezultat i saj kanë mbet pa u paguar shumë punëtorë, nënkontraktorë dhe/ose furnizues të materialeve.

Pagesa në shumën e limituar prej **2,117.00€** siç është lartcekur, pa pasur nevojë të vertetoni apo të tregoni arsyet ose shkaqet e kërkesës tuaj, apo për shumën e specifikuar këtu.

Kjo siguri vlenë 60 ditë kalendarike prej **01.08.2024** deri më **30.09.2024**

Me plotësimin e detyrimeve ndaj Përfituesit të Garancionit, Siguruesit/Garantuesit i kalon e drejta për ta rimbursuar nga i Siguruari/Kontraktuesi shumën e paguar përfituesit, me të gjitha të drejtat dhe mjetet ligjore deri në përmbushjen e tërësishme të detyrimeve.

Data lëshimit: 01.08.2024

Nënshkrimi dhe vula e garantuesit



Ky garancion i nënshtrohet rregullave uniforme për garancione (URDG), botim 2010, Publikimi ICC Nr. 758.



ELSIG

Gjithcka që duhet ta keni

Kompania e Sigurimeve Sh.A./Insurance Company J.S.C.
Kompania e sigurimeve ELSIG sh.a , Prishtinë, Adresa: Rr. "Tringë Ismajli"-nr,19,
Tel: +383 (0) 38 221 112: Fax: +383 (0) 38 221 115, E-mail: office@kselsig.com



POLICË PËR SIGURIMIN E GARANCISË SË EKZEKUTIMIT TË KONTRATËS

Nr. Polices: **128919**

Kontraktuesi	
Emri	ENG GEO GROUP SH.P.K.
Përfaqësuar nga	MENSUR SERTOLLI
Adresa	Bellanicë, Rruga Imer Bellanica, p.n.
Nr i Biznesit	811590331
Telefoni	049718472

Përfituesi	
Emri	KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT
Adresa	PRIZREN

Garantuesi	
Emri	Elsig
Banka	NLB
Garantuesit	

Mbulueshmëria e Polices	
Shuma Siguar	2,117.00
Periudha Sigurimit	01.08.2024 - 30.09.2024
Primi	38.11
Tvsh	6.86
Primi Bruto	44.97
Data e lëshimit	01.08.2024 10:16

Aktiviteti Ekonomik:
Ndërtimi dhe vendosja e shtëpizave mobile ne kuadër të projektit Ringjallja e Zejeve dhe Ndërtimi i Kultures për Zhvillimin e përbashkët të turizmit ne Bazë të marrëveshjes për bashkëpunim me nr 2022 434-320 ne mes të BE dhe KK Prizren

Lënda e Garancisë

Detyrimet e Siguruesit ndaj Përfituesit sipas kësaj Police të sigurimit janë:

- Mbështetur në këtë Police - Garancie, Siguruesi / Garantuesi merre përsipër që të plotësojë çdo detyrim kontraktori i cili është i garantuar me këtë police.
- Përfituesi e ka të drejtën t'i drejtohet Siguruesit / Garantuesit për marrjen e dëmshpërblimit deri në shumën e garantuar, vetëm kur detyrimet kontraktuale nuk plotësohen për faj të të Siguarit / Kontraktuesit - Ekzekutuesit të Kontratës.
- Me plotësimin e detyrimeve ndaj Përfituesit, Siguruesit/Garantuesit i lind e drejta që t'i drejtohet të Siguarit/Kontraktuesit, me të gjitha mjetet ligjore, për të bërë rimbursimin e shpenzimeve të kryera në funksion të plotësimit të detyrimeve ndaj përfituesit (cedimi i të drejtave nga Përfituesi të Siguruesit/Garantuesit).
- Ky sigurim është lidhur sipas Kushteve të përgjithshme të Sigurimit të Garancive dhe ekzekutimit të kontratës të cilat janë pjesë përbërëse e kësaj Police.
- Për polica të sigurimit - Ekzekutimi i kontratave - pjesë përbërëse e kësaj police është kontrata e ekzekutimit të punëve ndërmjet autoritetit kontraktues (Përfituesi) dhe Operatori Ekzekutues (të Siguarit) di dhe marrëveshja e lidhur në mes Siguruesit dhe Operatorit Ekonomik (hipoteka e lënë peng)

Me nënshkrimin e kësaj kontrate pajtohem që Kompania e Sigurimit ti ruaj të dhënat e mia personale / të dhënat e biznesit, të cilat do të përdoren nga Kompania për qëllime statistikore, hulumtim/raportim në Regjistrin Kreditor të Kosovës si dhe transferim tek një palë e tretë me qëllim të trajtimit të dëmeve.

Me nënshkrimin e kësaj police të sigurimit, nënkuptohet se unë i siguruari me vullnet të lirë, të barabartë dhe me mirëbesim kam pranuar primin e sigurimit, kam lexuar, kuptuar dhe pranuar kushtet e sigurimit.
My signature in this insurance policy signifies that I the insured with good will have accepted the insurance premium. I have read, understood and accepted the insurance terms and conditions



Kompania e Sigurimeve Elsig
Leudona Balaj - 2589



Përfaqësuesi i të siguarit
MENSUR SERTOLLI